



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më.12 januar 2012  
Nr. ref.: RK180/11

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI 101/11**

Parashtruesi

Isma Bunjaku

**Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës  
PPA nr. 4/2009 të datës 27.4.2011**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

**Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është znj. Isma Bunjaku nga fshati Vinarc komuna e Mitrovicës me vendbanim të përhershëm në fshatin Samadrexhë komuna e Vushtrrisë

### **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik me të cilin pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutën e Kosovës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, PPA.nr. 4/2009 të datës 27.4.2011.

### **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së lëndës së parashtruar më 28 korrik 2011 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës është vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PPA. nr. 4/2009 të datës 27.4.2011 për të cilin parashtruesi i kërkesës nuk kishte specifikuar se në cilën datë e ka pranuar.

### **Shkeljet e pretenduara të drejtave të garantuara Kushtetuese**

4. Parashtruesi i kërkesës nuk ka përcaktuar saktësisht se cila e drejtë e garantuar me kushtetutë i është cenuar por ka theksuar se me vendimet e sfiduara asaj i janë cenuar të drejtat “sipas ligjeve në fuqi, Kushtetutës dhe Konventave ndërkombëtare”.

### **Baza juridike**

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i dt. 16 dhjetor 2009 i hyrë në fuqi më 15 janar 2010 (në tekstin e mëtejshëm referuar si Ligji), dhe Neni 29 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm i referuar si rregullorja).

### **Ankesa e parashtruesit**

6. Parashtruesja e ankesës ka pohuar se Komisionet mjekësore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejshëm MPMS) ia kanë refuzuar në mënyrë joligjore të “drejtën për pension me aftësi të kufizuara” edhe pse ajo i ka plotësuar kushtet për një pension të tillë, ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës duke refuzuar padinë e saj lidhur me këtë çështje dhe duke refuzuar edhe kërkesën për Përsëritjen e Procedurës, gjithashtu ka bërë të njëjtën shkelje, sepse sipas parashtrueses së ankesës ajo ka paaftësi të përhershme për punë dhe atë e ka provuar edhe me dokumentacion mjekësor.

### **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

7. Më 28 korrik 2011 Gjykata Kushtetuese pranoi kërkesën e znj. Isma Bunjaku dhe e regjistroi atë me nr. KI 101/11..
8. Më 17 gusht 2011 me vendimin GJR 101/11 Kryetari i Gjykatës caktoi Gjyqtar raportues, gjyqtaren dr. Iliriana Islami.

9. Të njëjtën ditë Kryetrari i Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje: Robert Carolan (kryesues) dhe gjyqtarët Ivan Čukalović e Mr. sc. Kadri Kryeziu në cilësi të anëtarëve të kolegjit
10. Më 17 tetor 2011 Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar Gjykatën Supreme të Kosovës dhe përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e lëndës por nuk kishte marrë asnjë koment nga asnjëra palë. Gjykata po ashtu me këtë datë ka njoftuar edhe Departamentin e Administratës Pensionale të MPMS lidhur me kërkesën, duke kërkuar dokumentacionin relevant nga ky departament.
11. Më 1 nëntor 2011 Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka pranuar nga Departamenti i Administratës Pensionale të MPMS dokumentacionin e kërkuar.
12. Me 30 nëntor 2011 Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

13. Më 27 dhjetor 204 znj. Isma Bunjaku nga fshati Samadrexhë i kishte parashtruar kërkesë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës me të cilën nga ky Institucion ka kërkuar njohjen e të drejtës për Pension të Personave me Aftësi të Kufizuara.
14. Me 16 gusht 2005 Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës kishte nxjerrë Vendimin me nr. të dosjes 5057358, me të cilin kishte refuzuar kërkesën e znj. Bunjaku me arsyetimin se nga komisioni mjekësor tek ajo është konstatuar **“aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme” nuk ekziston.**
15. Më 30.11.2005 Këshilli i Ankesave për pensionet e personave me Aftësi të Kufizuara i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka refuzuar si të pabazuar ankesën e znj. Isma Bunjaku, dhe me Aktvendimin me nr. të dosjes 5057358 ka konstatuar se vendimi i shkallës së parë ka qenë i bazuar në ligj dhe i drejtë.
16. Më 5.4.2006 Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas padisë së znj. Isma Bunjaku në procedurën e Konfliktit Administrativ ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr.223/2006 me anë të cilit ka pranuar padinë dhe ka anuluar Aktvendimin e Këshillit të Ankesave të MPMS me nr të dosjes 5057358 të datës 30.11.2005 për shkak të mungesës së pjesës arsyetuese gjatë marrjes së atij vendimi.
17. Nga shkresat e lëndës të dërguara zyrtarisht nga MPMS-Departamenti i Administratës Pensionale, konstatohet se, Këshilli i Ankesave përherë të dytë kishte vendosur për ankesën e znj. Isma Bunjaku më 31 maj 2006 duke nxjerrë përsëri Aktvendim Refuzues dhe duke e lënë në fuqi vendimin e komisionit mjekësor të shkallës së parë të datës 16 gusht 2005 ku kërkonte përsheptimin e procedurës në Gjykatën Komunale. Këtë Aktgjykim znj. Bunjaku e kishte pranuar më 8. 4.2011.
18. Më 26.09 2007 Gjykata Supreme e Kosovës përsëri duke vendosur sipas padisë së re për Konflikt Administrativ ndaj Aktvendimit të Këshillit të Ankesave të MPMS tash të datës 31 maj 2006, ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr.1558/2006 me të cilin për herë të dytë është miratuar Padia e paditëses znj. Isma Bunjaku dhe është anuluar

Aktvendimi i Këshillit të Ankesave të MPMS i datës 31 maj 2006 i cili mbante nr. e njëjtë të dosjes 5057358.

19. Më 7 nëntor 2007, Këshilli i ankesave i MPMS duke vepruar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A.nr.1558/2006 të datës 26.9.2007 për herë të tretë ka vendosur lidhur me Ankesën e znj. Isma Bunjaku dhe me këtë rast ka nxjerrë Aktvendimin me nr. të njëjtë të dosjes 5057358, përsëri duke REFUZUAR ankesën e parashtruar nga znj. Bunjaku, por kësaj here duke dhënë edhe arsyetimin e duhur për marrjen këtij Aktvendimi.
20. Znj. Bunjaku edhe ndaj këtij Aktvendimi prapë ka parashtruar padi për Konflikt administrativ e Gjykata Supreme me Aktgjykimin nr. A.956/2008 të datës 17 nëntor 2008 ka refuzuar padinë e paraqitur.
21. Kundër këtij Aktgjykimi z. Bunjaku përmes avokates znj. Fatmire Braha më 3 mars 2009 ka paraqitur në Gjykatën Supreme të Kosovës “Kërkesën për Përsëritjen e Procedurës Administrative”.
22. Më 27 prill 2011, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktvendimin PPA. nr. 4/2009 me të cilin HODHI poshtë Kërkesën për Përsëritjen e Procedurës me arsyetimin se pala kërkuese nuk kishte ofruar prova të reja që do të justifikonin përsëritjen e procedurës.
23. Më 28 korrik 2011, përfundimisht e pakënaqur me vendimet e lartcekura z. Isma Bunjaku paraqiti kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

24. Për të qenë në gjendje për të gjykuar për Kërkesën e Parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen në Kushtetutë.
25. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton se:

*"Individët janë të autorizuar të ngrenë **shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar te gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.**"*

- 26, Gjykata Gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese ku përcaktohet:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:  
c) kërkesa është qartazi e bazuar.”

27. Në fakt duke iu referuar shkeljes së supozuar të së drejtës për pension Gjykata, konstaton se Kushtetuta e Kosovës të drejtës së pensionit i referohet vetëm në nenin 105 dhe 109 të saj, edhe atë duke iu referuar procesit të mandatit dhe riemërimit të

Gjyqtarëve dhe Prokurorëve për të cilët përdoret formulimi kushtetues **”deri në pensionim sipas ligjit”**

28. Në Nenin 51 të Kushtetutës [**Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale**] paragrafi 2 është qartazi e paraparë: ”Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj.”
29. Nga përkufizimi juridik i Nenit 51 të Kushtetutës shihet qartë se sigurimi social për “aftësi të kufizuara, papunësi dhe moshë të shtyrë” rregullohet me LIGJ, në rastin konkret çështja e pensionit me aftësi të kufizuara është e rregulluar me Ligjin NR.2003/23 PËR PENSIONET E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË KOSOVË të aprovuar në Kuvendin e Kosovës më 6 nëntor 2003.
30. Procedurat e aplikimit, dhe të plotësimit të kushteve për gëzimin e kësaj të drejtë janë të parapara me këtë Ligj sikur edhe e drejta e apelimit të vendimeve kur palët nuk janë të kënaqura me vendimet lidhur me kërkesën e tyre.
- 31.. Komisionet Administrative të MPMS-së kishin vepruar pikërisht në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj përfundimtar A. 956/2008 të datës 17 nëntor 2008 kishte konstatuar se këto vendime ishin Ligjore.
32. Gjykata Kushtetuese nuk është Gjykatë e verifikimit të fakteve dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike të drejtë dhe të plotë është juridiksion i plotë i Gjykatave të rregullta dhe në këtë rast edhe i organeve administrative dhe se roli i saj është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt", (shih *mutatis mutandis*, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).
33. Nga faktet e paraqitura së bashku me kërkesën shihet se parashtruesi i saj nuk ka përmbushur obligimin ligjor të saktësisimit të kërkesës sepse ai nuk ka specifikuar qartë se cila e drejtë e garantuar me Kushtetutë i është cenuar nga aktet e autoriteteve publike. Për më tepër, Gjykata konsideron se në kërkesë nuk ka asgjë që tregon se Gjykatës, dhe në këtë rast edhe komisioneve të MPMS-së gjatë ekzaminimit të rastit, i mungonte paanshmëria ose që procedura ishte e padrejtë. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t’u shërbejë atyre si e drejtë që të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të Nenit 31 të Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* aktgjykim ECHR Appl. No. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).
34. Në këto rrethana parashtruesi ankesës nuk ka “argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij” andaj, kolegjit shqyrtues i propozoj që në përputhje me rregullin 36 paragrafi 2 pika c dhe d kërkesën ta refuzojë si qartazi të pabazuar, dhe

**PËR KËTO ARSYE**

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullit 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese më 30 nëntor, njëzëri

## VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Dr. Iliriana Islami

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. Dr. Enver Hasani